



Në bazë të nenit 20 të Ligjit për Planifikimin Hapësinor nr. 04 / L -174 neni 9 te Ligjit nr .03/ L – 230 për Vlerësimin Strategjik Mjedisor neni 17 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, neni 5 të Udhëzimit administrativ të MMPH nr. 5 4/2005 për Zbatimin e Ligjit për Planifikimin hapësinor mbi procedurën e shqyrtimit publik për planet hapësinore dhe urbanistike, neni 65 të Statutit të Komunës së Klinës, Kryetari i komunës më dt. 28. 01.2014, bie këtë:

VENDIM

Mbi

Shpalljen e debatit për shqyrtimin e Draftit të Vlerësimit Strategjik Mjedisor të -PZHK të Komunës së Klinës 2011-2021

I

Më këtë vendim shpallet shqyrtimi publik i draft të Vlerësimit Strategjik Mjedisor të Planit Zhvillimor Komunal (PZHK-al)të Komunës së Klinës 2011-2021 i cili organizohet nga Drejtoria komunale e Urbanizmit dhe Mbrojtjes së Mjedisit në Klinë.

II

Shqyrtimi publik mbahet duke filluar nga dt. 12 02.2014 me fillim nga ora 10,00 dhe zgjatë 30 ditë dhe do të mbahet në sallën e Kuvendit të Komunës, ku do të bëhet edhe ekspozimi i draft dokumentit të Vlerësimit Strategjik Mjedisor të Planit Zhvillimor Komunal i hartuar nga kompania “INSI” nga Prishtina, për marrjen e opinionit , sugjerimeve , komenteve, vërejtjeve për Vlerësimin Strategjik Mjedisor , pjesëmarrja e qytetarëve , grupeve të interesit, bartësve të institucioneve publike ne komune ,anuarve të Kuvendit komunal si dhe të gjithë të interesuarit etj. Ne dhenjen e komenteve gjatë shqyrtimit publik e qe komentet dhe të gjithë kontributet tjera do të jetë ne interes për të gjithë.

Komentet ne formë të shkruar mund të drejtohen ne Drejtorin Urbanizmit dhe Mbrojtjen e Mjedisit oso ne kk.rks-gov.net/kline.

III

Të drejt pjesëmarrje në shqyrtim publik kanë të gjithë qytetaret e Komunës së Klinës si dhe subjektet tjera të interesuara dhe involvuara në hartimin, miratimin dhe zbatimin të Vlerësimit Strategjik Mjedisit të PZHK-ës.

IV

Konsultimet, komentet, pyetjet, sugjerimet, plotësimet, ndryshimet etj. qofshin ato verbale dhe me shkrim mund të i drejtohen Ekipës profesionale-zyrtarve kompetent të Drejtorisë komunale

të Urbanizimit dhe Mbrojtjes së Mjedisit në Klinë apo drejtorit të saj, të cilët gjatë gjithë kohës do të kujdesën për procedimin e rregullt dhe ligjor të shqyrtimit publik.

V

Pas mbyllës së shqyrtimit publik, vërejtjet dhe parashtrirat me shkrim do të dorëzohen për shqyrtim dhe analizë profesionale hartuesit të këtij drafti të Vlerësimit Strategjik Mjedisor të PZHK-ës Kompanisë „INSI,, me seli në Prishtinë, më mundësi të inkuorporimit të atyre vërejtjeve dhe parashtrirave në dokumentin final.

VI

Zyra komunale për Informim dhe mardhenje me Publikun do të kujdeset për publikimin me kohë dhe të rregullt të këtij vendimi përmes informimit , radios ,ne mjetet e informimit publik ditor po edhe ne tabele te shpallur dhe ftesës përkatëse për qytetar.

VII

Mbikëqyrjen e zbatimit të këtij vendimi do ta bëjë Kryetari i Komunës së Klinës dhe Drejtoria komunale e Urbanizimit dhe Mbrojtjes së Mjedisit në Klinë.

VIII

Ky vendim hynë në fuqi menjëherë ditën e nënshkrimit.

IX

Vendimi i dërgohet Drejtorisë komunale për Urbanizim dhe Mbrojtje të Mjedisit në Klinë, hartuesit të draftit të V.S.M të PZHK-al Kompanisë „INSI,, Prishtinë, MMPH-or Prishtinë, Zyrës komunale për Informim dhe Mardhenjet me Publikun si dhe Arshivës.

06 Nr. 351-343 /2014
Klinë, më dt.28 .01.2014.

KOMUNA E KLINES
Kryetari,
Sokol Bashota

